

L I G J
Nr.7738, datë 21.7.1993

"PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.3766, DATË 17.12.1993
"PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.3766, datë 17.12.1963 "Për kujdesin shëndetësor", neni 8 ndryshohet si vijon:
"Shteti siguron, kundrejt shpërblimit në masën 100 për qind të çmimit, kryerjen e këtyre shërbimeve:

1. Lëshimin e certifikatave ose të dokumenteve me karakter tekniko-administrativ e mjekoligjor, individuale sipas kërkesës së tyre, nga institucionet shëndetësore shtetërore.
2. Pajisjen me proteza të çdo lloji (dentare, ortopedike etj.).
3. Trajtimin dhe ndërhyrjen mjekësore ambulatorë të parekomanduar nga mjeku ose me karakter kozmetik, sipas kërkesës së individëve.
4. Trajtimin në qendrat balneologjike hidrominerare të çdo lloji.
5. Shërbimet tekniko-laboratorike ose veprimtari të tjera të karakterit mjekësor, të kërkuara prej personave juridikë e fizikë.
6. Përdorimin e gjakut për nevoja mjekësore, jourgjente, në marës jokronik të gjakut, kur në familjen e tij nuk ka donator pa shpërblim (vullnetar) që të ketë dhënë gjak brenda një viti.
7. Dhënien e barnave dhe të materialeve të tjera mjekësore sipas përjashtimeve dhe masave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Shteti siguron kundrejt shpërblimit në masën 70 për qind të çmimit kryerjen e këtyre shërbimeve:

1. Të gjitha veprimet e shërbimeve mjekësore stomatologjike ambulatorë për moshën mbi 18 vjeç.
2. Shërbimet mjekësore jourgjente të kryera në shtëpi, sipas kërkesës së individëve.
3. Vizitat mjekësore te specialistët e shërbimit ambulator, sipas kërkesës së individit.

Neni 2

Të ardhurat që sigurohen nga këto shërbime shëndetësore, shkojnë në dobi të sistemit shëndetësor shtetëror.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 4

Paragrafi i dytë i nenit 6 të ligjit nr.7718 datë 3.6.1993 "Për disa ndryshime në ligjin nr.3766, datë 17.12.1963 "Për kujdesin shëndetësor", shfuqizohet.

Shpallur me dekretin nr.620, datë 4.8.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

